



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M

Nr. 85 datë 25.08.2026

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË KONSULTIMEVE ME KOMUNITETIN NË
KUADËR TË NDARJES ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË
QEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Këshilli Bashkiak Përmet, në mbledhjen e dates 25 .08.2026, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga grupi i deputetëve propozues të mazhorancës parlamentare, anëtarë të Komisionit të Posaçëm Parlamentar Për Reformën Administrativo-Territoriale, relacionin shpjegues dhe materialet shoqëruese.

BAZUAR NË:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Neni 108, pika 2;
 - Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenet 86–93;
 - Ligjin nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
 - Ligjin nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
 - aktet dhe udhëzimet përkatëse që lidhen me procesin e Reformës Administrative-Territoriale;
 - si dhe në përputhje me kompetencat e Këshillit Bashkiak,
- Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë “**Kalendarin e konsultimeve me komunitetin në kuadër të Reformës Administrative-Territoriale**”, sipas përcaktimeve të paraqitura në **Aneksin nr. 1**, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Konsultimet publike do të zhvillohen në territorin e Bashkisë Përmet, duke përfshirë njësitë administrative dhe komunitetet përkatëse, me qëllim garantimin e një procesi sa më gjithëpërfshirës dhe përfaqësues.
3. Për çdo takim konsultimi të mbahet **procesverbal**, ku të pasqyrohen pjesëmarrësit, çështjet e diskutuara, mendimet, propozimet dhe sugjerimet e paraqitura nga komuniteti.
4. Bashkia Përmet të garantojë njoftimin në kohë të komunitetit për datën, orën, vendin dhe objektin e çdo takimi konsultues, nëpërmjet mjeteve të përshtatshme të komunikimit publik.

5. Pas përfundimit të konsultimeve, administrata e Bashkisë Përmet të përgatisë një **raport përmbledhës të procesit të konsultimit**, ku të pasqyrohen takimet e zhvilluara, pjesëmarrja, problematikat e ngritura, propozimet e komunitetit dhe mënyra e trajtimit të tyre.
6. Kryetari i Bashkisë Përmet, strukturat përgjegjëse të administratës së bashkisë dhe njësité administrative të marrin masat për zbatimin e këtij vendimi dhe realizimin e konsultimeve sipas kalendarit të miratuar.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Përmet, strukturat përgjegjëse të administratës së Bashkisë dhe Njësité Administrative.
8. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Përmet dhe në mënyra të tjera të përshtatshme për informimin e publikut, në përputhje me legjislacionin në fuqi për transparencën dhe konsultimin publik.
9. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE



KRYETAR
Anila DHIMITRI



[Signature] 026



ANEKS NR. 1

KALENDARI I TAKIMEVE PUBLIKE ME KOMUNITETIN NË KUADËR TË PROCESIT TË KONSULTIMIT PËR REFORMËN ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Nr.	Konsultimi	Vendi	Data	Ora
1	Dëgjese publike me operatorët turistikë, biznese dhe grupe interesi, qyteti Përmet	Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Përmet	08.09.2026	10.00
2	Dëgjese publike me biznese, banorë dhe grupe interesi në Njësine Administrative Çarshovë	Njesia Administrative Çarshove	08.09.2026	18.00
3	Dëgjese publike me biznese, banorë dhe grupe interesi në Njësine Administrative Petran	Njesia Administrative Petran	09.09.2026	18.00
4	Dëgjese publike me OJF që ushtrojnë aktivitetin në Përmet	Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Përmet	09.09.2026	10.00
5	Dëgjese publike me biznese, banorë dhe grupe interesi në Njësine Administrative Piskovë	Njesia Administrative Piskovë	10.09.2026	18.00
6	Dëgjese publike me gratë dhe të rinjtë	Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Përmet	10.09.2026	10.00

Sugjerimet dhe komentet mund të dërgohen pranë zyrës së Protokollit në Bashkinë Përmet ose nëpërmjet adresave të email: info@bashkiapermet.gov.al dhe keshillibashkiakpermet@gmail.com.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Aleks TANE

KRYETAR KËSHILLI

Anila DHIMITRI

